

Zhvillohet takimi vjetor i Bordit Ndërkombëtar të Audituesve për NATO-n

Bordi Ndërkombëtar i Audituesve për NATO-n (The International Board of Auditors for NATO-IBAN) zhvilloi në Bruksel më datën 15 Maj 2024 takimin me përfaqësues nga Trupat Kompetente Audituese Kombëtare (Competent National Audit Bodies- CNAB) mbi aktivitetin e vitit 2023.

Bordi Ndërkombëtar i Audituesve për NATO-n i ofron Këshillit të Atlantikut të Veriut dhe qeverive të shteteve anëtare të NATO-s sigurinë se raportimet financiare janë të drejta dhe se fondet janë përdorur siç duhet sipas shpenzimeve të autorizuar. Përveç kësaj, ka për mision rishikimin e operacioneve të Komandave dhe Agjencive të NATO-s për të përcaktuar nëse ato kryhen me efektivitet dhe ekonomicitet.

Veprimtaria audituese e Bordit karakterizohet nga pavarësia, udhëhiqet nga integriteti dhe në aktivitetin e tij planifikues, ekzekutues dhe raportues zbaton profesionalizmin, bazuar në parimet dhe udhëzimet e Organizatës Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit.

Gjatë këtij takimi u diskutua mbi Raportin e aktivitetit vjetor 2023, për të cilin referoi Kryetar i Bordit të IBAN z. Radek Visinger.

Në vijim nga ekspertë të fushës së auditimit të jashtëm shtetëror u prezantuan temat: “Roli i SAI-eve në fuqizimin e llogaridhënies dhe transparencës në sektorin publik” dhe “Implementimi i rekomandimeve dhe auditimi i zbatimit të tyre në auditimet e performancës”, të cilat u shoqëruan me diskutime nga të pranishmit.



Në këtë takim morën pjesë përfaqësues të Institucioneve Supreme të Auditimit nga 26 shtete anëtare të NATO-s.

Kontrolli i Lartë i Shtetit u përfaqësua nga z. Gjovalin Preçi, Drejtor i Departamentit të Auditimit të Buxhetit të Shtetit, si dhe z. Aldo Kume, Auditues i Lartë në Departamentin e Auditimit të Institucioneve Qendrore.